
Fetnan Dervish

Arsimim i barabartë për të gjithë?

Sfidat e Arsimit në Kosovë në Mbretërinë SKS



Pyetja kyçe

Në cilën masë kushtet shoqërore kanë qenë pengesë për arsimimin e individit?

Tema

Ky modul flet për të drejtat arsimore të pakicës myslimane, e pranuar si pakicë fetare (religjioze). Megjithatë, e drejta e arsimimit në gjuhën amtare (shqipe, turke) nuk i është dhënë pakicës fetare myslimane, sepse ajo nuk ka qenë e pranuar si pakicë etnike, kështu që myslimanët nuk janë arsimuar bashkërisht me fëmijët serbë në klasat e njëjta, por në klasa të ndara. Ky modul merret me arsimimin e pakicës myslimane.

Moduli e mbulon periudhën nga viti 1918 – 1941.

-Në mbretëri ka jetuar një numër i konsiderueshëm i popullsisë myslimane. Arsyeja për të cilën është zgjedhur kjo temë është të diskutohet pyetja e kësaj popullsie e cila ka qenë e njohur si pakicë fetare dhe si është arsimuar ajo.

-Tema është kontroverse për shkak të qëndrimeve të ndryshme të palës serbe, shqiptare dhe turke për këtë çështje deri tani. Çështja është kontroverse edhe për shkak të vendit ku ka ndodhur arsimimi i fëmijëve myslimanë, ku nxënësit dhe mësuesit është dashur të përshtaten me rregullat dhe kërkesat e caktuara. Edhe pse kjo çështje është përpunuar vetëm në shembullin e Kosovës, për shkak të shumëllojshmërisë së pakicës myslimane në kuptimin etnik dhe fetar, kjo megjithatë është regjioni më karakteristik, dhe jep shembull të mirë i cili mund të zbatohet në tërë regjionin.

Qëllimet

- Kuptimi kritik i natyrës së ndërlikuar të së kaluarës
- Kuptimi i identitetit nacional
- Zhvillimi i vetëdijes historike

Rezultatet e mësimit:

- Nxënësit do të analizojnë dhe interpretojnë lloje të ndryshme të burimeve historike;
- Nxënësit do të vlerësojnë çka ka qenë problemi themelor i arsimimit të pakicave – karakteri etnik ose fetar;
- Nxënësit do ta krahasojnë dhe vlerësojnë rëndësinë e burimeve të ofruara për analizë të problemeve të arsimimit të myslimanëve në Mbretërinë SKS (dokumente zyrtare, kujtime të pjesëmarrësve, gazeta, etj.)

90 minuta

Udhëzime për mësimdhënësit

Hapi 1. Mësimdhënësi e lexon materialin e planifikuar për hyrje.

Hapi 2. Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe, i ndanë burimet dhe sqaron cili grup cilën detyrë e ka.

Grupi 1: Të drejtat e garantuara të pakicave dhe marrëveshjeve në kushtetutën e Vidovdanit*. Si është organizuar arsimimin i pakicës myslimane ndaj të drejtave të dhëna?

Grupi 2: Perspektivat e burimeve të ndryshme.

Grupi 3: Kujtimet e nxënësve të cilët janë shkolluar në shkollat e pakicave.

Grupi 4: Hulumtimi i burimeve primare – dëshmive, diplomave, artikujve të gazetës.

Grupi 5: Përvojat personale

Hapi 3. Çdo grup i kryen detyrat e dhëna, i gjen përgjigjet dhe diskuton për pyetjet e dhëna.

Hapi 4. Secili grup do ta prezantojë punën, do të shkruajë përgjigje (rezultate) në tabelë.

Hapi 5. Diskutimi final. Secili grup paraqet përgjigjet e veta në pyetjet e dhëna dhe argumentet e mbështetura në burime. Përgjigjet mësimdhënësi do t'i shkruajë në tabelë.

HYRJE

Pyetje:
- Cila ka qenë gjendja e përgjithshme në Kosovë mes dy luftërave botërore?
- Cilat kanë qenë vështirësitë më të mëdha në organizimin e mësimit?
- Cila është arsyeja për mungesën e arsimimit të pakicës myslimane në gjuhën amtare?

Burimi **1**

Gjendja e përgjithshme në Kosovë mes dy luftërave botërore

Me themelimin e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve më 1 dhjetor 1918 edhe Kosova bëhet pjesë e kësaj mbretërie. Pakicës myslimane nuk ia janë dhënë të drejtat nacionale, dhe kjo ka qenë arsye që të organizohen për çështjen e të drejtave politike dhe nacionale. Në vitin 1919 ata themelojnë parti politike. Kjo parti ka pasur edhe botimin e saj. Mes dy luftërave botërore Kosova ka qenë zona më e varfër dhe më e pazhvilluar në mbretëri. Shumica e popullsisë është marrë me bujqësi. Për shkak të mungesës së arsimit në gjuhën amtare shumica e myslimanëve është shkolluar nëpër medrese. Por, arsimimi nëpër medrese është bërë pa plan dhe program dhe pa libra. Ngecja ekonomike, arsimore dhe sociale në Kosovë ka ndikuar edhe në ngecjen kulturore.

B. Koro, Tarih 9, Pristina 2008, str. 57-59.

Burimi **2**

Vështirësitë në organizimin e arsimimit

"Programet shkollore në Mbretërinë Jugosllave kanë qenë të ndryshme. Nuk kanë pasur asgjë të përbashkët popujt e ndryshëm, kulturat dhe sundimtarët gjatë kohërave të ndryshme. Kjo ka qenë bashkësi e vështirë e dallimeve – Evropë orientale dhe e Mesme, popuj dhe traditat e tyre. Nuk ka qenë e lehtë të vendoset kjo nën një sistem të njëjtë arsimor dhe juridik. Ka munguar mundësia e përparimit dhe zhvillimin në përgjatë arsimimit. Problemi më i madh kanë qenë prindërit konservativë, fëmijët e gjinisë femërore nuk janë dërguar në shkollë, dhe kjo ka qenë njëra nga arsyet pse një pjesë e madhe e bashkësisë ka mbetur pa arsimim.

Branko Petranović, İstorija Jugoslavije, Knjiga I. Kraljevina Jugoslavije, http://www.znaci.net/00001/93_2.pdf (downloaded May 11, 2013)

.

Burimi **3**

Ndikimi i rrethanave në arsimimin e myslimanëve në gjuhën amtare (turke, shqiptare)

Me migrimin e myslimanëve pas Luftërave Ballkanike, u zhvendosën edhe individët dhe popullsia e arsimuar turke. Këto rrethana kanë pasur ndikim negativ në arsimimin e tyre dhe gjuhën amtare (turke, shqipe). Rezultati i kësaj ka qenë që arsimimi në gjuhën shqipe dhe turke është ndërprerë. Megjithatë, migrimi i popullsisë nuk ka qenë arsyeja e vetme për këtë ndërprerje.
Në vitet e përmendura, në Mbretërinë e S.K.S./Jugosllavisë, myslimanët kanë qenë të pranuar si pakicë fetare, e jo si etnike. Pakica fetare myslimane ka qenë me përkatësi të ndryshme etnike, shqiptare dhe turke, dhe ata nuk kanë folur me gjuhën e njëjtë.
Pas shkatërrimit të Austro-Hungarisë dhe me mbarimin e Luftës së Parë Botërore, është formuar Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Një numër i rëndësishëm i myslimanëve kanë jetuar në këtë Mbretëri. Kjo gjë e ka parashtruar çështjen e statusit fetar dhe qytetar-juridik të myslimanëve.

F. Karčić, Šerijatski Sudovi u Jugoslaviji, Sarajevo 1986,str. 27-2.

Grupi 1

Të drejtat e garantuara të pakicave në marrëveshjet dhe në Kushtetutën e Vidovdanit.
Si është organizuar arsimimi i pakicës myslimane sipas të drejtave të dhëna?

Burimi 1

Pas themelimit të Mbretërisë S.K.S., çfarë të drejtash u janë dhënë pakicave?

Deklarata e Korfuzit – 1917.
-Religjionet e pranuara janë të lira: ortodoks, katolik dhe mysliman. Këta janë masat më të mëdha në shtet.
-Të gjitha këta përbërës kanë të drejta të barabarta në shtet.
-Parimet themelore të këtyre rregullave kanë qenë rruajtja e paqes fetare dhe integritetit të tërë kombit.

M. Ekmečić, Stvaranje Jugoslavije 1790-1918, p. 67) http://www.znaci.net/00001/138_7.pdf (downloaded May 11, 2013)

Burimi 2

Marrëveshja e Shën Zhermenit – 1919.

Sipas marrëveshjes së Shën Zhermenit të 10 shtatorit 1919, popullsia myslimane, siç janë:
-shqiptarët, turqit, boshnjakët, romët, të cilët kanë jetuar në Mbretëri, janë pranuar si "pakica fetare".
-Sipas kësaj marrëveshjeje, Mbretëria e S.K.S. e ka marrë përgjegjësinë për popullsinë e përkatësisë fetare islame e cila ka jetuar në territorin e shtetit.
-Si pakica etnike janë veçuar pakica bullgare, hungareze dhe gjermane.

Đ. Borozan, Osnovni Principi Zaštite Manjina u Kraljevini SHS 1919-1921. i Albanci u Kraljevini, p. 362, 372 http://www.cpi.hr/download/links/hr/7939.pdf downloaded May 11, 2013)

Burimi 3

Kushtetuta e Vidovdanit – 1921


Sipas nenin 16 të Kushtetutës së Vidovdanit, thuhej:
-Sipas ligjit do të jepet e drejta e arsimimit në gjuhën amtare.
-Arsimimi fetare do të organizohet sipas kërkesës së prindërve dhe marrëveshjes së përfaqësuesve të bashkësive fetare.

http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_navigacija/leksikon_jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije/vidovdanski_ustav.html (downloaded May 11, 2013)

Burimi 4

Numri i pakicave nacionale në Mbretërinë e S.K.S.

Numri i pjesëtarëve të pakicave, sipas regjistrimit të 31 janarit 1921.



Đ. Borozan, Osnovni Principi Zaštite Manjina u Kraljevini SHS 1919-1921. i Albanci u Kraljevini, http://www.cpi.hr/download/links/hr/7939.pdf, p. 370-371. (downloaded May 11, 2013)

Burimi **5**

Programi i parë arsimor

Në Mbretërinë e Jugosllavisë, programin e parë arsimor e ka bërë Ministria e Arsimit në vitit 1929. Sipas ligjit, në shkollat shtetërore ka qenë e domosdoshme të ekzistojnë klasa të posaçme për pakicat. Në klasa të ketë nga 30 nxënës. Në ato shkolla, pakicat nacionale është dashur ta ndjekin mësimin në gjuhën zyrtare të shtetit – serbisht.

Đ. Borozan, Osnovni Principi Zaštite Manjina u Kraljevini SHS 1919-1921. i Albanci u Kraljevini, http://www.cpi.hr/download/links/hr/7939.pdf , p. 374. downloaded May 11, 2013)

Burimi **6**

Ligji i bashkësisë fetare islame

-Në të gjitha shkollat, arsimimi fetar ka qenë lëndë e obligueshme mësimore, nën mbikëqyrjen e pushtetit kompetent fetar. (pika 17/1)
-Arsimim fetar nëpër shkolla duhet të ketë së paku dy orë në javë. Aty ku numri i nxënësve është i vogël mundet që më tepër klasë të mbajnë bashkërisht orë për arsimim fetar. (pika 17/4

Zakon o İslamskoj Verskoj Zajednici Kraljevine Jugoslavije, Državna Štamparija u Sarajevu, 1936, str. 8

Burimi **7**

Arsyet e hamendjeve serbe

-Fëmijët myslimanë orët e tyre të arsimit fetar i kanë mbajtur në shkollën "Mladen Ugareviç", të vendosur në qendër të Prizrenit, në Kosovë.
-Serbët nuk kanë miratuar që myslimanët dhe fëmijët e pjesëtarëve të religjioneve të tjera t'i ndjekin orët në shkollën të cilën e ka ndërtuar Kisha Ortodokse Serbe, nga fondacioni i Mladen Ugareviçit.

P. Kostić, Prosvetno Kulturni život Pravoslavnih Srba u Prizrenu i njegovoj okolini u XIX i početkom XX veka, Skoplje 1933, str. 122)

Burimi **8**


Mësuesit në shkollat myslimane

Shkollat e hapura për fëmijët myslimanë kanë pasur mësues serbë, ndërsa mësuesit e arsimimit fetar kanë qenë mësues shqiptarë ose turq. Këto, të ashtuquajtura orë myslimane, gjithashtu janë ndjekur edhe nga fëmijët katolikë shqiptarë.
Arsimin fetar për këta fëmijë e kanë mbajtur priftërinjtë.

M. Yarimhoroz, Representation of the other in language Textbook in Kosovo, master thesis , KİJAC, Prishtina 2007, str. 14-15)

Burimi **9**

Shkolla "Mladen Ugareviç" në të cilën fëmijët myslimanë kanë ndjekur arsimimin fetar



Mladen Ugareviç ka qenë tregtar i njohur nga Prizreni. Para vdekjes me testamentin e tij tërë pasurinë e tij e ka lënë për ndërtimin e një ndërtese shkollore. Shuma duhej mluo r n .jndhr q

Burimi **1**

Qëndrimi i serbëve për këtë çështje

"Sa u përket të drejtave të grupimit me qëllim të themelimit të shoqatave kulturore, arsimore dhe të tjera, kjo e drejtë nuk është shfrytëzuar "sepse shqiptarët nuk kanë ndjerë nevojë për grupim në fushën kulturore dhe ekonomike", edhe pse shteti për këtë nuk i ka penguar. Çështja është se në zonat e banuara me popullsi shqiptare funksionet fetare dhe arsimore i kanë ushtruar rreth 50 myftinj dhe mbi 600 imamë, "prej të cilëve asnjëri nuk e di mirë gjuhën serbe dhe të gjithë janë edukuar me frymë armiqësore ndaj nesh", ka ushtruar ndikim vendimtar në autoritet arsimore që *sibijan-mejtepet* (shkollat fillore) t'i konsiderojnë si "institucione të dëmshme nacionale".
Autoritetet shtetërore dhe arsimore edhe krahas kësaj i kanë toleruar këta institucione fetare-arsimore, duke e lejuar punën e tyre, sepse ata kryesisht i kanë plotësuar nevojat e popullsisë shqiptare dhe e kanë penguar që të kërkojë hapjen e shkollave me mësim në gjuhën shqipe. Meqë imamët të cilët në sibijan – mejtepet i kanë edukuar dhe shkolluar të rinjtë shqiptarë shumë keq e kanë ditur dhe pakë e kanë përdorur gjuhën shtetërore, pasojat e arsimit të këtillë kanë qenë shumë të këqija".

Đ. Borozan, The Basic Principle of Protection of Minorities in the Kingdom SHS 1919-1921. and Albanians in the Kingdom, p. 376 http://www.cpi.hr/download/links/hr/7939.pdf, downloaded 11 May 2013)

Burimi **1a**

Qëndrimi i serbëve për këtë çështje

"Rasti më i keq jashtë sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare ka qenë rasti i pakicës shqiptare. Ata nuk kanë pasur shkolla në gjuhën amtare dhe nuk kanë mundur të shfrytëzojnë gjuhët e tyre për komunikim zyrtar".

B. Petranovic, İstorija Jugoslavije 1918-1978, Beograd 1981, str. 34.

Burimi **2**

Qëndrimi i shqiptarëve për këtë çështje

"Prej vitit 1918, Mbretëria e S.K.S. në periudhë prej 23 viteve ka mbyllur rreth 50 shkolla në gjuhën shqipe. Gjatë kësaj periudhe gjuha shqipe nuk ka qenë e lejuar të shfrytëzohet si gjuhë nëpër shkolla. Gjuha e arsimit ka qenë ekskluzivisht gjuha serbe. Në të njëjtën kohë në Vojvodinë, për pakicat nacionale ka ekzistuar arsimimi në gjuhën e tyre amtare. Në vitin shkollor 1927-1928, në Kosovë ka pasur 7565 nxënës, prej kësaj 7333 fëmijë meshkuj dhe 232 vajza. Për shkak të mungesës së mësuesve shqiptarë, ata nuk kanë kërkuar të mësohet në gjuhën shqipe nëpër shkolla. Kur kanë parashtruar kërkesë për arsimim në gjuhën shqipe – si deputetit Ferhat Draga – shteti këtë nuk e ka miratuar".

B. Shatri, Arsimi Fillor në Kosovë në Shekullin XX, Prishtinë 2006, str. 42-43.)

Burimi **3**

Qëndrimi i turqve për këtë çështje

"Në periudhën mes dy luftërave botërore (1919-1941) në Kosovë, përveç shumicës shqiptare, turqit gjithashtu nuk kanë pasur të drejtën e arsimimit në gjuhën e tyre. Gjatë kësaj periudhe, 84% e popullsisë së Kosovës ka qenë e paarsimuar. Mes dy luftërave numri i vogël i fëmijëve shqiptarë dhe turq e kanë mbaruar shkollimin e mesëm në gjuhën shqipe. Në periudhën e njëjtë kohore:
-Vështirësitë financiare, diskriminimi dhe arsimimi i cili është mbajtur në gjuhën serbe, e cila ka qenë e huaj për turqit, ka qenë e pamundur të vazhdohet arsimimi i tyre.
Këta kanë qenë arsyet e nivelit të ulët të arsimimit në mesin e turqve.
Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat fillore në Kosovë ka qenë 37.885, prej tyre 20.914 kanë qenë fëmijë serbë dhe malazezë, ndërsa 11.876 kanë qenë shqiptarë. Në mesin e nxënësve shqiptarë ka pasur edhe disa turq. Numri i përgjithshëm i nxënësve shqiptarë dhe turq ka qenë 2%.

B. Koro, C. Topsakal, Kosova'da Yaşayan Türkçe Eğitim, Prizren 2007, str. 28-29.

Ngjashmëri	Dallime

Pyetje

- Cili ka qenë qëndrimi i serbëve për këtë çështje?
- Cili ka qenë qëndrimi i shqiptarëve për këtë çështje?
- Cili ka qenë qëndrimi i turqve për këtë çështje?

Burimi **1**

Për çka kujtohen nxënësit e shkollave të pakicave

Zahit Volkan, njëri nga mësuesit e parë turk në Kosovë, mësimin e tij fillor e ka filluar në shkollën fetare 1935-36.



"Ishin dy klasë në rrethin e shkollës katolike. Mësuesja jonë ishte murgeshë. Gjysma e nxënësve ishin fëmijë myslimanë, ndërsa gjysma tjetër katolikë. Në mesin e nxënësve myslimanë në këto klasë kishte dallime nacionale, veçanërisht në Prizren. Dy herë në javë, të martën dhe të premten, kishim orë mësimi fetar.
Këta orë të katolike-myslimane i ndiqnin nxënës të përkatësive të ndryshme etnike dhe të moshave të ndryshme".

Z. Volkan lindi në Prizren në vitin 1928, mësues i pensionuar. Ai mësoi në klasat myslimane-serbe në vitet 1935-1936. Kjo intervistë është bërë në shtëpinë e tij më 30 janar 2012.

Burimi **2**

Isha vajza e vetme nxënëse në klasë

Selvinaz Kovaç, e lindur në vitin 1926 në Prizren, amvise. Ajo ishte nxënëse në vitin shkollor 1932-33, në klasën myslimane-serbe.



"Në mbretërinë Jugosllave, në shkollë fillore shkohej që nga mosha 7 vjeçare. Shteti dërgonte thirrje për regjistrim në shkollë për të gjithë fëmijët të cilët i kanë mbushur 7 vjet.
Për fëmijët të cilët nuk e kanë ditur gjuhën serbe është organizuar mësim përgatitor për gjuhën serbe. Ne kryesisht nuk i ndiqnim këto orë, gjuhën serbe e kemi mësuar në shkollë.
Unë munda të shkoj në shkollë vetëm disa muaj, sepse isha nxënësja e vetme. Një ditë mësuesi im më tha se unë isha vajza e vetme në shkollë dhe se nuk duhet më të vij në shkollë. Për këtë arsye unë nuk kam mundur të shkoj në shkollë shtetërore dhe isha e detyruar të shkoj në xhami për arsimimin tim".

Informatat janë shënuar nga intervista e bërë në shtëpinë e saj më 15 janar 2012.

Burimi **3**

Situata e njëjtë është edhe në fshatra...

Murtezan Berisha është lindur në fshatin Dragash-Buça në vitin 1928, dhe është punëtor i pensionuar. Ai ka qenë nxënës në vitin shkollor 1935-36 në klasat myslimane-serbe.



"Në shkollën fillore shkova në vitin 1935-36. Në këtë shkollë vinin fëmijë nga fshatrat Breznë dhe Plavë. Në shkollë kam shkuar tre vite dhe mësuesi im ishte Dragomir Adamoviç nga Zagrebi i Kroacisë. Mësuesin e mbaj mend si person shumë të ngrohtë, i afërt me fëmijët. Mësimin fetar e kishim në xhaminë e fshatit Buçë. Mësimi fetar ishte në gjuhën shqipe dhe arabe".

Informatat janë shënuar nga intervista e bërë në shtëpinë e tij më 1 shkurt 2012.

Burimi **4**

Ekzistonte një praktikë e caktuar të cilën ishim të obligjuar ta respektojmë

S. Cufi, i lindur në Prizren në vitin 1925, teknik i farmacisë në pension. Ai i ka ndjekur orët myslimane-serbe gjatë viteve 1932-1936.



"Në shkollat shtetërore në Mbretërinë Jugosllave ka ekzistuar një praktikë e caktuar të cilën duhej ta ndjekin edhe fëmijët myslimanë. Në ditëlindjen e mbretit, më 6 shtator, të gjithë nxënësit dërgoheshin në xhami. Pas leximit të predikimit myftiu dhe imami thoshim "Të na rojë mbreti Pjetri i Dytë", ndërsa të gjithë nxënësit i përsërisnin këta fjalë pas tyre. Kishim festa gjatë bajramit të madh dhe të vogël, ndërsa gjithashtu edhe gjatë festave fetare të krishtera. Mësuesi im fetar ishte Destan Efendiu. Orët fetare ishin në gjuhën turke. Përveç temave fetare, mësuam edhe disa këngë turke".

Informatat janë shënuar nga intervista e bërë në shtëpinë e tij më 30 janar 2012.

Pyetje:


1. Çka kanë të përbashkët tregimet gojore, dhe cilat aspekte dallohen?

2. Çka mund të përfundohet për arsimimin e pakicës myslimane nga informatat e dhëna?

Burimi **1**

Regjistri i nxënësve të shkollave popullore

Regjistri i nxënësve të paraleles myslimane të vitit shkollor 1935-1936, të klasës së tretë (të shënuar në linjën e epërme horizontale të portokalltë). Në linjën e poshtme, të nënvizuar me ngjyrë të portokalltë, qëndron sqarimi për rubrikën vertikale në regjistër (të rrethuar me kornizë të portokalltë) se ka qenë e destinuar për shënimin e notave nga gjuha amtare në paralelet e pakicave nacionale në atë shkollë.




Arkivi Regjional Historik Prizren,
Upisnik Učenika Narodnih Škola, I/14.

Burimi **2**

Regjistri i nxënësve të shkollës nacionale

Regjistri i nxënësve të paraleles katolike – myslimane të klasës së parë (të shënuar në linjën e epërme horizontale të portokalltë) në vitin shkollor 1936-1937. Në linjën e poshtme, të nënvizuar me ngjyrë të portokalltë, qëndron sqarimi për rubrikën vertikale në regjistër (në kornizë të portokalltë) që ka qenë e përcaktuar për regjistrimin e notave nga gjuha amtare në paralelet e pakicave nacionale në atë shkollë.



Arkivi Regjional Historik Prizren,
Upisnik Učenika Narodnih Škola, I/14.


Burimi **3**

Dëftesë nga viti 1925

Sipas dëftesës së Hzr Ibrahim për mbarimin e klasës së katërt të shkollës fillore të vitit 1925, nxënësit i ndiqnin këto lëndë:

Mësim fetar
Gjuhë serbe
Histori serbe
Gjeografi
Bazat e fizikës
Matematikë dhe gjeometri
Punë dore – zeje
Vizatim
Kaligrafi
Këndim
Gjimnastikë
Kuran

Fondi Gjimnazi Real Plotesues Shtetrore,
njesia org. Prizren viti 1949-1950.



Burimi **4**

Dëftesë nga viti 1937

Sipas dëftesës së Shefki Kufiut për klasën e katërt të shkollës fillore, i cili shkollën fillore e ka mbaruan në vitin 1937, janë mësuar lëndët vijuese:

Shkenca mbi fenë me këshilla morale
Gjuhë popullore (serbe-kroate-sllovene)
Gjuhë e pakicave
Histori kombëtare
Gjeografi
Algjebër dhe gjeometri
Dituri natyre
Dituri praktike ekonomike dhe shkathtësi
Higjienë
Amvisëri
Punë dore
Vizatim
Bukurshkrim
Këndim
Edukatë fizike

Burimi **5**

Një artikull gazete për bibliotekën e vakëfit

Nxënësit të cilët kishin mundësi të tillë, mundnin të shkojnë në Shkup pas shkollës fillore në shkollim të mëtejshëm në "Medresenë e Mbretit Aleksandër".
(Medreseja është themeluar në kohën Osmane si "Medreseja Isa Beu". Në kohën e Mbretërisë Jugosllave emri i medresesë është ndryshuar në "Medreseja e Mbretit Aleksandër". Por populli edhe më tej vazhdon ta shfrytëzojë emërtimin e vjetër "Medreseja e Isa Beut".)

Dragan Novaković, "Organizacija i Položaj İslamske Verske Zajednice u Kraljevini Jugoslaviji", TEME, 2003, vol. 27, no. 3, p. 451-474.



Kolonel Enver Hoxhes dhe Lazar Kolishevskit, te cilet po i botojme ma poshte.

E njejta qfaqje, me 30-Dhetuer-1945, u-dha per grate e Shkupit dhe pati nji sukses shum te math.

kompakt ne zgjedhjet e II Nandorit per Asamblen Kushtetonjese.

Rrofte vllaznimi miqesh Maqedhonazvet dhe Shqiptarvet.

Nga Festa e 28 Nandorit ne Shkup.

Dy fjale per Biblioteken e Vakfit ne Shkup

Due te theksoj punen qe ka ba ne ndertesen ku gjindet tash mufqe ban dhe qe duhet te baje bitinija.

Me hapjen e Medreses »Gazi Isa Beg« me 1936, u-rihap edhe Biblioteka e Vakfit, e cila u-vendos ne vendin ku gjindet tash, dhe ma vone u-shperngul ne rrugen e Seravas, ne nji ndertese tjeter te Vakfit. Biblioteka qysh atehere qe o pajisun me libra te ndryshme ma teper ka

Ma se tre vjet rresht biblioteka nuk punoi si duhet. Ma teper rrinte e mbyllun se e hapun dhe ai qe kishte deshire per studime nuk mund te perfitonte.

Ta lame edhe kete kohe dhe e te kethehemi ne kete te sotshmen. Biblioteka e nalpermendun vazhdon te ngeli ne ate gjum le-

Antare kishte-mjaft dege te ndryshme per te bleme libra te reja porsa te dalluna nga shtypi.

Te rit, n'ate kohe, ne vend qe te bridheshin rrugevet ose te zhyteshin ne mes te tymit te duhanit ne kafene, si don ma te qe ku bisedojshin, kishte me randesi per sa u perkiste nevojave t'asaj kohe. Biblioteka ne fjale me te vertete u-ba nji qerdhe e rinis Shqiptare te Shkupit, me gjithe se nuk ishte e pajosun me as nje liber shqipe.

Shofesh sallen qe ka per t'u-duke si nji turbe e pafshime kurre. Asnji gazete mbi tavolinat e saje

Nga vjen kio? Nga pakujdesija e drejtorit te saje, ose nga vete populli te nji mendimin e

Punteri ose intelektuali s'dishiron ma te mbyte ne tymin e duhanit ner kafene, s'don ma te bredhi rrugeve si gjuska ne njimjergulle, por don qe te jete ne

Në vitin 1936 biblioteka e vakëfit është hapur me rastin e hapjes së Medresesë së Isa Beut. Biblioteka ka shumë libra. Librat janë në gjuhën arabe, turke dhe serbe. Biblioteka ka numër të mjaftueshëm të anëtarëve. Potenciali financiar shfrytëzohet për furnizim me libra. Të rinjtë, në vend që të enden rrugëve ose të qëndrojnë në hapësira të mbyllura dhe të tymosura, vijnë që të shoqërohen në bibliotekë dhe të bisedojnë për çështje aktuale. Edhe pse biblioteka nuk ka pasur libra në gjuhën shqipe, ajo megjithatë ka qenë vendtakim i rinisë shqiptare. Gjatë invadimit bullgar, librat janë marrë ndërsa biblioteka është kthyer në vendin e saj të mëparshëm..."

""Flaka e Vëllazërimit" 18.12.1945, Shkup

Pyetje:

1. Krahasoji lëndët në dëftesat e viteve 1925 dhe 1937, a ka ndryshim dhe në lëndët e ndjekura?
2. Në cilën pjesë të ditarit nxënësit nuk kanë fituar nota?
3. Cila është arsyeja për këtë?
4. Cila mund të jetë arsyeja e vendosjes së notave ose e mungesës së notave?
5. Cili ka qenë roli i Bibliotekës së Medresesë së Mbretit Aleksandër në përparimin e rinisë myslimane ku kishin mundësi ta vazhdojë arsimimin në shkollën e mesme fetare?

Ngjashmëri	Dallime

Burimi 1

Njëri nga intelektualët e parë të pakicës myslimane me prejardhje turke

Durmish Celina ka qenë njëri nga ata të cilët e kanë vazhduar arsimimin në këtë mënyrë. Ai e ka mbaruar shkollën fillore në vendlindjen e tij, Prizren. Shkollën e mesme e ka mbaruar në Plevle. Shkollimin universitar e ka filluar në Beograd. Megjithatë, më vonë është çregjistruar dhe është regjistruar në Universitetin e Zagrebit. Ka diplomuar në vitin 1942 dhe ka marrë diplomën e Shtetit të Pavarur Kroat. Pas kthimit në vendlindje, e ka përkthyer diplomën e cila ka qenë në gjuhën latine, në gjuhën shqipe. Këtë përkthim e ka ratifikuar Mbretëria Shqiptare në vitin 1942. Durmish Celina, i cili me sukses ka punuar si mjek në Kosovë, në vitin 1972 e ka bërë diagnozën e sëmundjes "Variola Vera", prandaj sëmundja është vendosur në karantinë dhe është penguar përhapja e saj nëpër Jugosllavi. Për këtë meritë i është ndarë titulli "Primarius".


Të dhënat janë marrë nga familja e Durmish Celinës

Burimi 2

Arsimimi universitar

Dëftesa vjetore e Durmish Celinës (atëherë Durmish Hurshidoviç) për mbarimin e vitit të tretë të gjimnazit në Plevle, në vitin shkollor 1930/1931. Lëndët të cilat janë mësuar janë si vijon:

Mësim fetar
Gjuhë serbe-kroate-sllovene
Gjuhë frënge
Gjuhë gjermane
Gjuhë latine
Gjeografi
Histori
Dituri natyre
Fizikë
Kimi
Matematikë
Gjeometri deskriptive
Ligjërime filozofike
Higjienë
Vizatim
Bukurshkrim
Gjimnastikë
Këndim



Burimi 3

Indeks nga Universiteti i Beogradit

Në Mbretëri universitete ekzistonin në Beograd, Lubjanë dhe Zagreb. Megjithatë, një numër shumë i vogël i studentëve myslimanë kishte mundësi t'i shfrytëzojë këto mundësi.



M. Anđelković, "Univerzitet u Kraljevini 1918-1941", Časopis Arhiva Jugoslavije, 1. 2000, str. 113-126

Burimi 4

Indeks i Universitetit të Zagrebit

Diplomë për mbarimin e Fakultetit të Mjekësisë në Zagreb, e lëshuar nga Shteti i Pavarur i Kroacisë.

Arkivi familjar i mjekut Durmish Celina



Burimi **4a**


Pulla administrative nga diploma universitare

Pullat administrative të Shtetit të Pavarur Kroat nga diploma universitare



Burimi **5**

Përkthimi i diplomës nga Universiteti i Zagrebit në gjuhën shqipe



Vërtetohet përkthimi i drejtë nga originali latinisht .
Tiranë,15/9/1942-XX.
Inspektori Epruer
pranë Ministris s'Arsimit
(Karl Gurakuqi)

Arkivi familjar i mjekut Durmish Celina

Burimi **5a**

Pulla administrative e Mbretërisë Shqiptare nga përkthimi i diplomës

Pas diplomimit Dr. Celina në vitin 1942 në vendlindje e përkthen diplomën në gjuhën shqipe, të cilën e vërtetoi Ministria e Arsimit e Mbretërisë Shqiptare.



Pyetje për Grupin 5:

1. Cilat janë shkencat ndihmëse të historisë të cilat merren me vulat dhe stemat?
2. Jepni sqarime për vulat nëpër diplomat.
3. Çfarë flet rruga arsimore e mjekut mysliman Dr. Durmish Celinës për sistemin arsimor, që filloi të studiojë në Kosovë – Prizren, mbaroi shkollën e mesme në Plevjle dhe më pas diplomoi në Universitetin e Zagrebit?
4. Për çka na flet ky shembull?

Diskutim final

Pyetje për diskutim final:

1. Krahasoni informatat gojore me të drejtat e dhëna në marrëveshjet dhe dokumentet e tjera.
2. A përputhen burimet gojore historike me faktet tjera?
3. Cilat janë pasojat e vendosjes së komponentëve të ndryshme etnike dhe fetare në sistemin e njëjtë arsimor?
4. A paraqet pengesë mungesa e arsimimit në gjuhën amtare për arsimimin e mëtejshëm të pakicës myslimane?
5. Diskutoni efektet e situatës së përgjithshme politike në arsim, me shembullin e diplomës së Durmish Celinës.